



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning And Infrastructure

**AGJENCIONI PËR MBROJTJEN
E MJEDISIT TË KOSOVËS**

**KOSOVSKA AGENCIJA
ZA ZAŠTITU SREDINE**

**KOSOVO ENVIRONMENTAL
PROTECTION AGENCY**

Plani i Performancës 2025

Prishtinë,
Dhjetor 2024

Plani i Performancës 2025

AGJENCIA	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës					
MINISTRIA PËRGJEGJËSE	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës					
Misioni i Agjencisë	Monitorimi i cilësisë dhe vetive të mjedisit si dhe sigurimi i informatave të duhur për administratën, Qeverinë dhe Kuvendin e Kosovës për zbatimin e politikave për mbrojtjen e mjedisit					
Objektivat	Treguesi(t)	Vlera bazë	Vlera e synuar	Rezultatet (Autputet)	Alokimi financiar	Referenca ndaj dokumenteve strategjike/politike
1. Përmirësimi i monitorimit, vlerësimit, raportimit dhe hulumtimit të gjendjes së zonave të mbrojtura dhe biodivesritetit	1. Numri i vizitave të rregullta të realizuara në zonat e mbrojtura;	30	35	Krijimi i një pasqyre të qartë për gjendjen e zonave të mbrojtura. Rritja e sipërfaqes dhe numrit të zonave të mbrojtura Monitorimi dhe raportimi për zonat e mbrojtura dhe biodivesritetit Kujdesi ndaj llojeve të faunës së mbrojtur	45,000.00 €	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji për mbrojtjen e natyrës, • Ligji për parqet kombëtare • Strategjia dhe Plani për biodiversitet • Rregullorja për organizimin dhe sistematizimin e vendeve te punës ne AMMK
	2. Numri i raporteve nga monitorimi dhe vlerësimi i gjendjes, evidentimi i problemeve aktuale dhe rekomandimi i masave përkatëse;	15	17			
	3. Numri i hulumtimeve/ studimeve për zonat e reja të natyrës dhe procedimi për mbrojtjen e tyre;	2	2			
	4. Numri i shënjimeve në zonat e mbrojtura	20	25			
2. Mirëmbajtja, avancimi i rrjetit të monitorimit të cilësisë së ajrit dhe hidrometeorologjisë	1. Numri i stacioneve për monitorimin e cilësisë së ajrit të mirëmbajtura;	13	13	Zgjerimi i rrjetit të monitorimit duke shtuar parametra tjerë monitorues dhe mirëmbajtja e qëndrueshme e stacioneve/ pajisjeve	Buxheti RKS dhe projektet në vazhdim	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji për veprimtaritë hidrometeorologjike • Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja • Ligji për mbrojtjen e mjedisit • Ligji për ujërat e Kosovës
	2. Numri i stacioneve te monitorimit hidrologjik i lumenjve të mirëmbajtura;	34	34			
	3. Numri i vend-mostrave në pikat e monitorimit te cilësisë së ujërave sipërfaqësorë;	56	56			
		40	40			

Plani i Performancës 2025

	4. Numri i vend-mostrave në pikat e monitorimit të ujërave nëntokësore; 5. Numri i stacioneve automatike dhe manuale meteorologjike të mirëmbajtura.	11	30			<ul style="list-style-type: none"> Programi i IHMK për monitorimin e gjendjes së mjedisit
3. Parandalimi i veprimeve ilegale për mbrojtjen e resurseve natyrore dhe fuqizimi me resurse humane në Parqet Kombëtare	1. Numri i veprimeve ilegale të prerjeve të Pyjeve; 2. Numri i veprimeve ilegale të ndërtimeve dhe infrastrukturës përcjellëse; 3. Shtimi i numrit të punësuarve me Rojtar të Natyrës, staf teknik dhe profesional; 4. Numri i veprimeve ilegale të shfrytëzimit të kullosave dhe gjuetisë.	70 160 3 10	65 150 12 6	Mbrojtja, ruajtja dhe zhvillimi i qëndrueshëm i territorit të Parqeve Kombëtare	Shtimi i projekteve dhe numri buxhetit	<ul style="list-style-type: none"> Ligji për Parkun Kombëtar “Sharri” dhe “Bjeshkët e Nemuna” Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Ligji për pyjet e Kosovës Ligji për gjuetinë Plani Hapësinor i Parkut Kombëtar “Sharri” dhe “Bjeshkët e Nemuna” Plani Menaxhues i Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” dhe “Sharri” Rregullorja për Rendin e Brendshëm të Parqeve Kombëtare Rregullorja për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në AMMK
1. Përmirësimi i shërbimeve dhe promovimi i MNRV “Shpella e Gadimës”	1. Numri i vizitorëve dhe menaxhimi i tyre 2. Shuma e të hyrave nga menaxhimi i vizitorëve. 3. Numri i broshurave dhe materialet promovuese. 4. Numri i projekteve për mirëmbajtjen e pajisjeve dhe ambienteve të shpellës	15,000.00 15,000.00 € 2000 3	15,500.00 16,000.00 € 2500 3	Rritjen e numrit të të hyrave në MNRV “Shpella e Gadimës”	23,000.00 € Broshura 5,000.00 €	<ul style="list-style-type: none"> Ligji për mbrojtjen e natyrës Ligji për financat publike Rregullorja e brendshme Rregullorja për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në AMMK
5. Përmirësimi i raportimit dhe informimit për gjendjen e mjedisit në	1. Numri i raporteve vjetore për gjendjen e mjedisit dhe sektorëve mjedisor të përgatitura.	5 8	6 10	Publikimi i tyre, informimi për gjendjen e mjedisit për publikun dhe	20,000.00 € (1-4)	<ul style="list-style-type: none"> Ligji për mbrojtjen e mjedisit, Ligji për mbeturinat

Plani i Performancës 2025

nivel, nacional dhe ndërkombëtarë	2. Numri i raporteve të dërguara në Agjencinë Europiane të Mjedisit / EEA.	9	10	rekomandimi për vendimmarrësit	60,000.00 € (5-7)	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja • Ligji për veprimtaritë hidrometeorologjike • Rregullorja për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në AMMK • Programi për menaxhimin e SIM 2024-2027
	3. Numri i raporteve mbi zbatimin e aktiviteteve të AMMK.	35	40			
	4. Numri i informative dhe aktivitete të publikuara në ueb faqen dhe rrjete sociale të AMMK.	0	1			
	5. Krijimi i CLC2024	5	6			
	6. Avacimi dhe përditësimi i gjeo data bazave dhe krijimi aplikacioneve të reja;	50	65			
7. Përgatitja e hartave tematike						

Pjesa përshkuese e Planit Vjetor të Përformancës së Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës për vitin 2025

Pjesa përshkuese është e bazuar në Nenin 9 – Forma dhe përmbajtja e Planit Vjetor të Përformancës, të Rregullores (QRK) Nr. 12/2023 mbi Sistemin e Menaxhimit të Performancës për Agjencitë në kuadër të Administratës Shtetërore ku është përcaktuar që në projekt plan të adresohen edhe:

- Afati zbatimit sipas tre-mujorëve;
- Sfidat specifike;
- Pajtimi me prioritet dhe objektivat afatmesme të ministrisë, përkatësisht Zyrës së Kryeministrit dhe Qeverisë të harmonizuara me Planin Vjetor të Punës së Qeverisë;
- Objektivat të kanë se paku një tregues të përformancës;
- Përcaktimin e departamentit apo njësinë përgjegjëse për zbatim; dhe
- Koston financiare për zbatimin dhe burimin buxhetor.

1. Sa i përket objektivës së parë: Hulumtimi dhe monitorimi i gjendjes së zonave të mbrojtura dhe biodiversitetit është planifikuar që afati i zbatimit do të jetë K1-K4.

- Sfida specifike për përmbushjen e objektivës parashikohet të jenë: mungesa e stafit, mungesa e pajisjeve të terrenit, mungesa e hapësirës / zyreve të IKMN, dhe veturat e terrenit.
- Objektiva është në pajtim me prioritet dhe objektivat afatmesme të ministrisë, përkatësisht Zyrës së Kryeministrit dhe Qeverisë të harmonizuara me Planin Vjetor të Punës së Qeverisë.

- Në këtë rast është përdorur treguesi sasior si tregues i performancës.
- Departamenti përgjegjës për zbatimin e kësaj objektive është Instituti i Kosovës për Mbrojtje të Natyrës / AMMK dhe komunat.
- Kurse kostoja financiare dhe burimin financiar planifikohet të ndahet nga buxheti i Republikë së Kosovës, dhe projektet me donatorë.

2. Objektiva e dytë, Monitorimi i cilësisë së ajrit dhe hidrometeorologjik siç edhe parashihet me ligj dhe plane te veçanta do të zbatohet gjatë gjithë vitit, pra në periudhën K1-K4.

- Sfida specifike – resurset humane, realizimi i projekteve sipas afateve, dhe vazhdimi i veprimtarisë pas përfundimit të projekteve, trajnimeve, avancimi i teknologjisë, funksionimi i aplikacioneve, mirëmbajtje permanente e stacioneve sipas sektorëve.
- Objektiva është në pajtim me prioritet dhe objektivat afatmesme të ministrisë, përkatësisht Zyrës së Kryeministrit dhe Qeverisë të harmonizuara me Planin Vjetor të Punës së Qeverisë.
- Treguesi i performancës është përdorur edhe në këtë rast sasior.
- Departamenti apo njësia përgjegjëse – Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës
- Kostoja financiare dhe burimi financiar – buxheti i Kosovës dhe donatorët.

3. Objektiva e tretë: Parandalimi i veprimeve ilegale dhe fuqizimi me resurse humane në Parqet Kombëtare është planifikuar që afati i zbatimit do të jetë K1-K4.

- Sfida specifike parashikohen të jenë: mungesa e resurseve humane (rojtari të natyrës, staf teknik dhe profesional), mungesa e pajisjeve teknike dhe teknologjike (aparata dixhital, kamera kurthë, dylbi, GPS, dron, vetura terreni, pajisja e rojtarëve me armë, përzierja e kompetencave institucionale, harmonizimi i legjislacionit, mungesa e akteve nënligjore, trajtimi me prioritet i lëndëve në Gjykata, kalimet ilegale të kufirit, Fuqizimi i Planit menaxhues të Produkteve Pyjore jo Drunore, bimëve mjekuese dhe aromatike .
- Objektiva është në pajtim me prioritet dhe objektivat afatmesme të ministrisë, përkatësisht Zyrës së Kryeministrit dhe Qeverisë të harmonizuara me Planin Vjetor të Punës së Qeverisë.
- Në këtë rast është përdorur treguesi sasior si tregues i performancës.
- Kostoja financiare dhe burimi financiar është paraparë të financohen nga buxheti i Republikës së Kosovës dhe donacionet.

4. Objektiva e katërt: Rritja e numrit të vizitorëve në MNRV “Shpella e Gadimes” është planifikuar që afati i zbatimit do të jetë K1-K4.

- Sfida specifike parashikohet të jetë mungesa e stafit profesional, trajnime të stafit, ndërtimet ilegale në territorin e mbrojtur të shpellës, mosshfrytëzimi në tërësi i galerive të shpellës, mos eksplorimi dhe mos hulumtimi i nivelit të sipërm të shpellës me korridore,

- Objektiva është në pajtim me prioritet dhe objektivat afatmesme të ministrisë, përkatësisht Zyrës së Kryeministrit dhe Qeverisë të harmonizuara me Planin Vjetor të Punës së Qeverisë.
- Në këtë rast është përdorur treguesi sasior si tregues i performancës.
- Departamenti apo njësia përgjegjëse është Drejtoria e Monumenteve Natyrës me Rëndësi të Veçantë / MNRV “Shpella e Gadimes”
- Kostoja financiare dhe burimi financiar është paraparë të ndahet nga buxheti i Kosovës.

5. Objektiva e pestë dhe e fundit: Raportimi mjedisor edhe sipas kërkesave ligjore është paraparë të realizohet në periudhën K1-K4.

- Sfida specifike parashikohet të jetë mungesa për raportim në EEA, sigurimi i të dhënave nga komunat dhe operatorët, hapja e të dhënave, mungesa e stafit, motivimi i stafit dhe mbajtja në funksion të plotë të aplikacioneve.
- Objektiva është në pajtim me prioritet dhe objektivat afatmesme të ministrisë, përkatësisht Zyrës së Kryeministrit dhe Qeverisë të harmonizuara me Planin Vjetor të Punës së Qeverisë.
- Në këtë rast është përdorur treguesi sasior si tregues i performancës
- Departamenti apo njësia përgjegjëse është Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës me përgjegjësi me të madhe Drejtoria për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit dhe Instituti Hidrometeorologjik.
- Kostoja financiare dhe burimi financiar – është paraparë nga buxheti i Republikës së Kosovës.

Hartuesit:

Selvije Raci Vitija, DVGJM – Kryesuese;

Hasim Kryeziu, DAPK “Sharri” – Anëtarë;

Adriana Pllana, MNRV “Shpella e Gadimes” – Anëtare;

Mentor Shala, IHMK – Anëtarë;

Sami Behrami, IHMK – Anëtarë.

AMMK:

Adresa: Ish-pallati i shtypit-Rilindja kati XV/04

Tel. +381 38 200 74 093:

Email: ammk@rks-gov.net; Ueb: www.ammk-rks.net

Prishtinë,

Dhjetor 2024